



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 360, Datë 13.07.2023

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË MBARIMIT TË KOHËZGJATJES SË
KOMANDIMIT PËR Z. {...}, GJYQTAR I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KUKËS, AKTUALISHT I KOMANDUAR NË
MINISTRINË E DREJTËSISË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, në nenin 57 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbështetur në nenet 41, 64, 90 dhe 94 të Kodit të Procedurave Administrative, pas shqyrtimit të kërkesës për revokimin e kërkesës së paraqitur për heqje dorë nga statusi i magjistratit, nga gjyqtari {...}, me propozim të relatorit z. Klodian Kurushi, Kryetar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI

1. Përfundimin e procedurës së mbarimit të kohëzgjatjes së komandimit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, aktualisht i komanduar në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të tërheqjes së tij nga kjo kërkesë.
2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR